



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE  
USTAVNI SUD  
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 30 qershor 2023  
Nr. ref.:RK 2226/23

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI117/22**

Parashtrues

**Musli Mehmetaj**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [PN. nr. 430/2022] të Gjykatës së  
Apelit të Kosovës – Departamenti për Krime të Rënda të 22 prillit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Musli Mehmetaj nga fshati Gllarevë, komuna e Klinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili është duke vuajtur dënimin në burgun e Dubravës - Komuna e Istogut. Parashtruesin e kërkesës e përfaqëson Korab Bokshi, avokat nga Gjakova.

## Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e aktvendimit [PN. nr. 430/2022], të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) të 22 prillit 2022, në lidhje me aktgjykimin [NJN. nr. 127/16], të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) të 28 janarit 2022.

## Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimeve të kontestuara përmes të cilëve, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij, të garantuara me nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

## Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), nenit 22 (Procedimi i kërkesës) dhe nenit 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

## Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 korrik 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 8 gusht 2022, Kryetarja e Gjykatës me Vendimin nr. [GJR. KI117/22] caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi Gjyqtare raportuese. Të njëjtën ditë, Kryetarja nxori vendimin [nr. KSH. KI117/22], përmes të cilit caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Remzije Istrefi-Peci (anëtarë).
7. Më 10 gusht 2022, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai të dorëzojë një autorizim specifik për përfaqësimin e parashtruesit të kërkesës në Gjykatë, në bazë të nenit 21 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës të Kosovës dhe rregullin 32 (2) (c) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese. Gjithashtu, në të njëjtën ditë, Gjykata i kërkoi përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës të dorëzojë një kopje të aktvendimit [P. nr. 430/2022] të Gjykatës së Apelit të 22 prillit 2022.
8. Më 19 gusht 2022, Gjykata dërgoi një kërkesë shtesë në Gjykatën Themelore, përmes së cilës kërkoi që në Gjykatë të dorëzojë dëshmi se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës ose përfaqësuesit të tij aktgjykimi i kontestuar [NJN. nr. 127/2016] i Gjykatës Themelore.
9. Më 7 shtator 2022, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi aktvendimin [P. nr. 430/2022] e Gjykatës së Apelit të 22 prillit 2022, së bashku me autorizimin për përfaqësimin e parashtruesit të kërkesës në procedurën pranë kësaj gjykate..

10. Më 16 dhjetor 2022, gjyqtari Enver Peci dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
11. Më 23 maj 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

12. Që në fillim të shqyrtimit të përmbledhjes së fakteve, Gjykata gjen se më 6 gusht 2005, parashtruesi i kërkesës me disa persona, me armë zjarri ka hyrë në hapësirat e objektit të Bankës Amerikane në Tiranë, Republika e Shqipërisë dhe në bashkëkryerje me persona të tjerë ka kryer grabitje të bankës. Autoritetet policore të Republikës së Shqipërisë e privuan nga liria parashtruesin e kërkesës dhe kështu filloi procedura penale kundër tij.
13. Më 10 shkurt 2015, parashtruesi i kërkesës është shpallur fajtor për kryerjen e veprave të rënda penale me aktgjykimin [nr. 18] të Gjykatës Themelore për Krime të Rënda në Tiranë "Vjedhjes se bankave" në bashkëpunim në formën e "Grupit të strukturuar Kriminal" parashikuar me nenin 136/3,28-4; të "Grupit të strukturuar kriminal" nga neni 333 germa "a" dhe të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake nga neni 378/2 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë," me ç'rast edhe u dënua me 12 vite burgim.
14. Parashtruesi i kërkesës kundër aktgjykimit [nr. 18] të Gjykatës Themelore për Krime të Rënda në Tiranë parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda në Tiranë.
15. Më 15 qershor 2015, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda në Tiranë nxori aktgjykimin [nr. 68] përmes të cilit refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, ndërsa vërtetoi në tërësi aktgjykimin [nr. 18] të Gjykatës Themelore për Krime të Rënda në Tiranë, duke i dhënë fund procedurës penale kundër parashtruesit të kërkesës me aktgjykim të formës së prerë.
16. Gjykata rikujton se më 6 nëntor 2012, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshjen për transferimin e personave të dënuar, e cila ka hyrë në fuqi më 27 dhjetor 2012.
17. Rrjedhimisht, në bazë të asaj marrëveshjeje të nënshkruar, më 18 shkurt 2016, Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë i dërgoi kërkesë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës, përmes së cilës transferimin e parashtruesit të kërkesës për të vuajtur dënimin me burg në territorin e Republika e Kosovës.
18. Më 28 tetor 2016, Ministria e Drejtësisë së Kosovës përmes kërkesës [numër 05-1288/3] dhe në bazë të nenit 63, paragrafi 1, pika 1.1. dhe paragrafi 2 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, lejoi transferimin e parashtruesit të kërkesës me procedurën e vazhimit të vuajtjes së pjesës së mbetur të dënimit në burgun e Dubravës në Istog. Rrjedhimisht, u krye transferimi i parashtruesit të kërkesës dhe ai është dërguar në vuajtje të dënimit me burg.
19. Më 10 gusht 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore, në pajtim me nenin 63 par. 2 të Ligjit Nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, kërkesë për ndryshim (konvertim) të dënimit të parashtruesit të kërkesës. Në kërkesë përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës deklaroi "Konform nenit 11 lidhur me nenin 10 par. 2 të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për Transferimin e Personave të

*Dënuar, e nënshkruar me dt. 06.11.2012 e ratifikuar nga Parlamentet e të dyja vendeve, lidhur me nenin 63 par. 1 pika 1.1 të Ligji nr. 04/1-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale - Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.33/ 2 shtator 2013, i dënuari Musli Mehmetaj, plotëson kushtet ligjore që ti ekzekutohet dhe të i konvertohet dënimi konform dispozitave të Republikës së Kosovës [...] t'i shqiptohen dënime më të buta në përputhje me dispozitat ligjore të cilat kanë qenë të aplikueshme në Kosovë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe dispozitat ligjore të lartëcekura ...”.*

20. *Më 28 tetor 2020, Gjykata Themelore nxori aktvendimin [NJN. nr. 127/16] përmes të cilit refuzoi kërkesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës për konvertimin e dënimit si të palejueshme, me arsyetimi se “konform nenit 65 par. 3 të Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, është paraparë që procedura e konvertimit duhet të përfundoj para transferimit të personit të dënuar”.*
21. *Më 3 nëntor 2020, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar që aktvendimi [NJN. nr. 127/16] i Gjykatës Themelore të 28 tetorit 2020 të ndryshohet dhe të miratohet kërkesa e parashtruesit për ndryshim (konvertim) të dënimit, me pretendimin se “nuk ka vlerësuar drejtë dhe saktë gjendjen faktike; si dhe ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale në përcaktimin e tij.”*
22. *Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës i bazoi këto pretendime mbi bazën se në përputhje me nenin 63, pika 2, të Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, ka përcaktuar se “Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e konvertimit të dënimit me rastin e transferimit të personit nga një shtet në shtetin tjetër, dhe Gjykata Themelore e Prishtinës në rastin e parashtruesit të kërkesës nuk ka marrë parasysh dallimin në mes të lartësisë së dënimit për të njëjtën veprë penale në mes të shtetit dënues dhe atij zbatues ...”*
23. *Më 8 dhjetor 2020, Gjykata e Apelit nxori aktvendimin [P. nr. 937/20], përmes të cilit aprovoi ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe anuloi aktvendimin [NJN. nr. 127/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë të 28 tetorit 2020, duke e kthyer lëndën në rivendosje.*
24. *Në arsyetimin e aktvendimit [P. nr. 937/20], Gjykata e Apelit vlerësoi:*

*“[...] konform dispozitës së nenit 63 par. 2 të Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjen penale, është përcaktuar se Gjykata Themelore në Prishtinë është kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e konvertimit të dënimit po ashtu kjo dispozite ka përcaktuar kriteret sipas se cilave gjykata duhet sipas detyrës zyrtare të bëjë vlerësimin e dënimit të shtetit dënues dhe aplikimin e të njëjtit konform dispozitave ligjore të shtetit zbatues. Në rrethanat e këtilla dhe duke ju referuar nenit 63 par. 1.1 dhe nenit 65 par. 2.4 të Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar qartazi rezulton se janë përmbushur arsyet ligjore lidhur me përmbushjen e kriterëve ligjore, dallimet mes legjislacionit të shtetit dënues Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit të shtetit zbatues Republikës së Kosovës duke e ditur faktin se sipas kësaj dispozite në këtë çështje aplikohet edhe Konventa e Këshillit të Evropës për transferimin e personave të dënuar përkritazi neni 11 pika C sipas së cilës shteti zbatues shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuan nga personi i dënuar ndërsa pika D e kësaj marrëveshje shteti zbatues nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar ti përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikoj ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera, andaj*

nga kjo rrjedh se vendimi i shkallës së parë si e tillë është në kundërshtim me marrëveshjen Këshillit të Evropës për transferimin e personave të dënuar, pasi që në rastin konkret duhet ti referohemi marrëveshjes e jo ligjit.

Gjykata e Apelit gjen se në rastin konkret, përkundër se dispozitat e ligjit për bashkëpunim juridik ndërkombëtare kanë përcaktuar se, konvertimi i dënimit duhet të bëhet para transferimit të të dënuarit, kjo gjykatë rikujton se Marrëveshja e lidhur ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë për transferimin e personave të dënuar e dekretuar me datë 27.12.2012, në nenin 11 "Konvertimi i dënimit" paragrafi 2, parasheh: "Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, pala zbatuese e mban atë person të dënuar ose siguron në ndonjë mënyrë pranin e tij derisa të dal rezultati i procedurës".

25. Pas kthimit të lëndës në rivendosje më 28 janar 2022, Gjykata Themelore nxori aktgjykim në procedurë të përsëritur [NJN. nr. 127/2016], me të cilin i pandehuri (parashtruesi i kërkesës) është shpallur fajtor për vepra penale "Rastet e rënda të vjedhjes grabitçare apo grabitjes nga neni 256 par. 1 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës dhe veprës penale; Mbajtja në pronësi në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armës nga neni 328 par. 1 të Kodit të përkohshëm penal të Kosovës", dhe i shqiptoi dënim unik në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) vitesh burgim.
26. Në arsyetimin e aktgjykimit [NJN. nr. 127/2016], Gjykata Themelore *inter alia* theksoi:

"Kolegji Shqyrtues i Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke u bazuar në nenin 11 të marrëveshjes së Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për transferimin e personave të dënuar edhe pse i mori parasyshë dhe iu përmbajt konstatimeve të fakteve në tersi dhe arsyeve të dhëna në aktgjykimin e Gjykatës së huaj dhe u dakordua me të, por duke pasur parasysh faktin se dënimi i shqiptuar për kah natyra dhe kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin vendor - Kodit të përkohshëm penal të Kosovës si ligj më i favorshëm dhe i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale / ku si dënim për veprën penale" Vjedhje e bankave arkave të kursimit me pasoja të rënda me Kodit penal të Republikës së Shqipërisë kryesi dënohet me burgim nga 10 deri ne 20 vjet/ ku sipas KPPK-së për vepër penale Rastet e rënda të vjedhjes grabitçare apo grabitjes nga neni 256 par. 1 kryesi dënohet me burgim më së paku 5 vjet burgim dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve par. 1 kryesi dënohet me burgim prej 1 deri ne 10 vjet dhe kësisoj e bëri konvertimin e tij ashtu që të pandehurit me rastin e matjes së dënimit për këtë vepër i caktoj dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 12 (dymbëdhjetë) vitesh.

Kolegji po ashtu , edhe me rastin e matjes së dënimit, i mori dhe i pat parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat gjykata e huaj i ka pasur parasysh me rastin e shqyrtimit të sanksionit - dënimit dhe konsideron se dënimi i shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljet dhe rrethanat nën të cilat është kryer vepra penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit dhe është i bindur se dënimi i shqiptuar do të ndikojë në risocializimin e tij si dhe do të ndikojë te të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, e që është edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit."

27. Në anën tjetër, lidhur me udhëzimin për mjetin juridik, Gjykata Themelore në përfundim të aktgjykimit [NJN. nr. 127/2016], theksoi, “Bazuar në nenin 63 par. 2 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në çështjet penale nr. 04/L/213, kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa”.
28. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktgjykimit [NJN. nr. 127/2016], të Gjykatës Themelore, përmes të cilit refuzoi kërkesën për konvertimin e dënimit me burg të parashtruesit të kërkesës.
29. Më 22 prill 2022, Gjykata e Apelit nxori aktvendimin [PN. nr. 430/2022], përmes të cilit refuzoi ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës si të papranueshme, me arsyetimin se;

*“Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, ankesa mbrojtësit të dënuar Musli Mehmetaj, avokat Korab Bokshi është e palejuar, ngase nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Prishtinë, [NJN. nr. 127/2016] i datës 28.01.2022 duke vendosur sipas kërkesës se të dënuarit konvertimin e dënimit të shqiptuar nga ana e gjykatave të Republikës së Shqipërisë.*

*Andaj, pasi që ankesa është paraqitur nga ana e mbrojtësit të dënuarit e njëjta u hodhe poshtë si e palejuara, pasi që me dispozitën e nenit 63 par. 2 të Ligjit për Bashkëpunim Juridike Ndërkombëtare në çështjet penale - ceket se “Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e përmendur sipas paragrafit I të këtij neni. Vendimet nuk mund të ankimohen” e konform kësaj dispozite në pjesën e këshillës juridike gjykata e shkallës së parë ndaj aktgjykimit NJN. nr. 127/2016 i datës 28.01.2022 nuk ka lejuar ankesë. prandaj konform dispozitës së nenit 63 të ligjit të lartcekur në lidhje me nenin 400 të KPP. ankesa e mbrojtësit është e palejuar, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

30. Parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes udhëzimeve për mjetin juridik në aktvendimin [PN. nr. 430/2022] të Gjykatës së Apelit, si dhe aktgjykimin [NJN. nr. 127/2016] të Gjykatës Themelore, ka ardhur deri te shkelja e të drejtave të përcaktuara në nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së.

### ***Pretendimet përkitazi me shkeljen e neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së***

31. Lidhur me shkeljen e neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës thekson se udhëzimi për mjetin juridik në aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë [NJN. nr. 127/2016] i 28 janarit 2022, është në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës, pasi i pamundësoi parashtruesit të kërkesës të shfrytëzojë mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore që cenonin të drejtat ose interesat e tij, siç përcaktohet në Kushtetutë. Në këtë rast konkret, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës pretendon se “gjykatat e rregullta kanë përdorur kriter të ndryshëm në të njëjtën çështje juridike. Në vendosje për herë të parë në kërkesën e parashtruesit, me Aktvendimin NJN. nr. 127/16 dt. 28.10.2020, ka refuzuar si të palejuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës i është lejuar e drejta në ankesë. Pas kthimit në rivendosje të asaj çështje gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin NJN. nr. 127/2016 dt. 28.01.2022, nuk ka lejuar të drejtën në ankesë. D.m.th. gjykatat e rregullta kanë përdorur standard të dyfishtë në trajtimin e kësaj çështje gjyqësore”.

32. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës gjithashtu shton se shkeljet e lartpërmendura kanë ndodhur për shkak se parashtruesit nuk i është lejuar të shfrytëzojnë të drejtën e ankesës, gjë që i ka mohuar mbrojtjen gjyqësore të të drejtave të tij, të cilat janë të garantuara me nenin 54 të Kushtetutës së Kosovës. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës mbështet këto konkludime në rastin [KI41/12 \(Gëzim i Makfire Kastrati\)](#) ku vlerëson se Gjykata Kushtetuese ka vendosur standard të sigurimit të mjeteve juridike, në të cilin rast ajo citon: “...si në rastin [Gëzim dhe Makfire Kastrati \(KI41/12\)](#) në të cilin rast përcakton se “në nivel kombëtar të një mjeteve juridik për ta zbatuar substancën e të drejtave dhe lirive të parapara me Konventë, në çfarëdo formë që mund të ndodhin për të qenë i siguruar në rendin ligjor të vendit.” Gjithashtu, sa i përket nenit 13 të KEDNJ-së, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës vlerëson se: “Qëllimi i nenit 13 është të kërkojë sigurimin e një mjeteve juridik vendor për ta trajtuar substancën e një 'pretendimi të diskutueshëm' sipas Konventës dhe për të ofruar mbrojtje përkatëse juridike”. (Shih Aktgjykimin 63/10, të 30 tetorit 2010, paragrafi 91). Në këtë drejtim, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës i referohet disa vendimeve të tjera të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në aspektin e përmbushjes së nenit 13 të KEDNJ-së, si më poshtë: “Gjithashtu, edhe nëse një mjet i vetëm juridik nuk i kënaq në tërësi kriteret e nenit 13, tërësia e mjeteve juridike të parapara me ligjin e vendit mund ta bëjë një gjë të tillë (Shih Aktgjykimin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin [Silver dhe të tjerët kundër aktgjykimit të Mbretërisë së Bashkuar, të 25 marsit 1983, Serija A, nr. 61, f. 42, para. 113\)](#)”. (Ibid., paragrafi 92)”.
33. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që ta deklarojë kërkesën e pranueshme dhe të konstatojë se përmes aktgjykimit [NJN. nr. 127/2016] të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, si dhe aktvendimit [PN. nr. 430/2022], të Gjykatës së Apelit është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës për mjet juridik, e cila është e paraparë me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 31

#### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

#### Neni 32

#### [E Drejta për Mjete Juridike]

“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”.

#### Neni 54

### **[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

#### **Neni 102**

### **[Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor]**

*[...]*

*“5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese”.*

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

#### **Neni 6.1**

### **(E drejta për një proces të rregullt)**

*1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj,  
[...]*

#### **Neni 13**

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

### **KONVENTA EVROPIANE PËR TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR**

*[...]*

#### **Neni 11**

### **Konvertimi i dënimit**

*“1. Në rastin e konvertimit të dënimit zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:*  
*a. duhet t’u përmbahet konstatimeve për faktet kur ato shfaqen shprehimisht ose nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;*  
*b. nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;*  
*c. shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë që vuhet nga personi i dënuar; dhe*  
*d. nuk e rëndon dënimin e personit të dënuar dhe nuk është i detyruar t’i përmbahet ndonjë minimumi që mund të parashikojë ligji i vendit zbatues për veprën ose veprat e kryera”*  
*[...]*



**MARRËVESHJA PËR EKSTRADIM, NDIHMË TË NDËRSJELLË JURIDIKE NË ÇËSHTJE PENALE DHE TRANSFERIMIN E PERSONAVE TË DËNUAR, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (në aplikim nga 27 dhjetori 2012)**

**Neni 11  
Konvertimi i dënimit**

1. *“Në rastin e konvertimit të dënimit, zbatohen procedurat e parashikuara nga ligji i shtetit zbatues. Kur bëhet konvertimi i dënimit, organi kompetent:*

- i) duhet t’u përmbahet konstatimeve në lidhje me faktet e përcaktuara shprehimisht ose që nënkuptohen nga vendimi i dhënë nga shteti dënues;*
  - ii) nuk mund të konvertojë një dënim me burgim në një dënim me gjobë;*
  - iii) shkurton periudhën e plotë të heqjes së lirisë së vuajtur nga personi i dënuar;*
2. *Nëse procedura e konvertimit kryhet pas transferimit të personit të dënuar, shteti zbatues e mban atë person të ndaluar ose siguron në ndonjë mënyrë tjetër praninë e tij në shtetin zbatues, derisa të dalë rezultati i procedurës”.*

**LIGJI NR. 04/L-213 PËR BASHKËPUNIM JURIDIK NDËRKOMBËTAR NË ÇËSHTJET PENALE (në aplikim nga 31 korriku 2013)**

**Neni 63  
Procedura e Ekzekutimit**

1. *“Personat që transferohen në bazë të këtij ligji i nënshtrohen njëres nga procedurave të e mëposhtme:*

1.1. *vazhdimin të ekzekutimit dënimit, kur shteti dënues është shtet anëtar i Bashkimit Evropian, apo shtet me të cilin Republika e Kosovës ka marrëveshje ndërkombëtare me të cilat parasheh vazhdimin e dënimit;*

1.2. *konvertimit të dënimit, kur shteti dënues është shtet tjetër nga ata të përmendur në paragrafin 1.1. të këtij neni.*

2. *Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e përmendur sipas paragrafit 1. të këtij neni. Vendimet nuk mund të ankimohen ”.*

**Neni 64  
Vazhdimi i ekzekutimit të dënimit**

1. *“Në rastet e referuara në paragrafin 1.1. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente do të lëshoj vendim me të cilin vazhdon ekzekutimin e dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues. Gjykata është e detyruar t’i përmbahet natyrës ligjore dhe kohëzgjatjes së dënimit të shqiptuar në Shtetin dënues.*

2. *Në rast se dënimi i shqiptuar në Shtetin dënues, për nga natyra ose kohëzgjatja nuk përputhet me ligjin vendor, dënimi duhet të konvertohet në përputhje me nenin 65 të këtij ligji”.*

**Neni 65  
Konvertimi i Dënimit**

1. "Në rastet e referuara në paragrafin 1.2. të nenit 63 të këtij ligji, gjykata kompetente lëshon vendim me të cilin shqipton dënim në pajtim me ligjin vendor.

2. Gjykata gjatë konvertimit të dënimit duhet:

[...]

1.3. t'i përmbahet gjetjeve të paraqitura në gjykimin e shqiptuar nga shteti dënues;

1.4. të mos konvertojë dënimin me burgim në dënim me gjobë;

1.5. të llogaris në dënimin final kohën e mbajtur të dënimit në shtetin dënues nga personi i dënuar, dhe

1.6. të mos rëndoj statusin penal të personit të dënuar dhe nuk është e lidhur me dënimin minimal të përcaktuar për atë vepër penale me ligjin e shtetit dënues.

3. Procedura e konvertimit duhet të përfundojë para transferimit të personit të dënuar".

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

34. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.

35. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë se:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".*

[...]

36. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47*

*[Kërkesa individuale]*

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

*Neni 48*

*[Saktësimi i kërkesës]*

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht secilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

Neni 49  
[Afatet]

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”*

37. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, i cili konteston aktin e autoritetit publik, përkatësisht aktvendimin [PN. nr. 430/2022], e Gjykatës së Apelit të 22 prillit 2022, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka theksuar të drejtat dhe liritë kushtetuese të cilat ai pretendon se i janë shkëlur, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë, në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
38. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe rregullit 39 (Kriteret e pranueshmërisë) të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
39. Gjykata së pari thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si *“qartazi e pabazuar”* në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si *“pretendime qartazi të pabazuara”*. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime *“të shkallës së katërt”*; (ii) pretendime që kategorizohen me një *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”*; (iii) pretendime *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, dhe në fund, (iv) pretendime *“konfuzë dhe të paqarta”* (shih rastet e GJEDNJ-së, *Kemmachev kundër Francës* kërkesa nr. [17621/91](#), kategoria (i), *Mentzen kundër Lituaniës*, kërkesa nr. [71074/01](#), kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës* kërkesa nr. [4241/03](#), kategoria (iii)).
41. Me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht vlerësimit nëse e njëjta është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës në procedurën penale të zhvilluar në Republikën e Shqipërisë është dënuar me 12 vjet burg në vendim të formës së prerë. Gjykata rikujton gjithashtu se në bazë të

marrëveshjes dypalëshe të nënshkruar ndërmjet dy vendeve, e cila përmban të drejta dhe detyrime të përcaktuara të të gjitha palëve, parashtruesi i kërkesës është transferuar nga burgu në Republikën e Shqipërisë në burgun e Dubravës që ndodhet në Republikën e Kosovës. për të vuajtur pjesën e mbetur të dënimit.

43. Megjithatë, Gjykata vëren se bazuar në thelbin e kërkesës së parashtruesit të kërkesës, objekti i kërkesës që gjendet në shqyrtim në këtë gjykatë nuk është në lidhje të drejtpërdrejtë me atë procedurë gjyqësore, por me procedurën gjyqësore të iniciuar nga përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës. pas përfundimit të procedurës së transferimit të parashtruesit të kërkesës për të vuajtur dënimin me burg në Republikën e Kosovës. Pikërisht në lidhje me atë procedurë gjyqësore, parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta i kanë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës si dhe me nenin 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
44. Duke pasur parasysh këtë, në vazhdim të aktvendimit, Gjykata do të shqyrtojë në detaje pretendimet e parashtruesit të kërkesës, të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me procedurën gjyqësore të zhvilluar në gjykatat e rregullta në Republikën e Kosovës.

#### **Procedura gjyqësore në gjykatat të rregullta në Republikën e Kosovës në lidhje me kërkesën për ulje të dënimit**

45. Duke parë procedurën gjyqësore që është objekt shqyrtimi në këtë gjykatë, Gjykata konstaton se ajo ka të bëjë ekskluzivisht me procedurën e konvertimit, përkatësisht uljen e dënimit me 12 vjet burg me të cilin parashtruesi i kërkesës është dënuar në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me këtë, Gjykata konstaton se përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si gjykatë me kompetencë lëndore, për njohjen e aktgjykimit të gjykatës së huaj, përmes së cilës ka kërkuar uljen e dënimit me 12 vjet burg për parashtruesin e kërkesës, duke qenë se janë plotësuar të gjitha kërkesat ligjore.
46. Para se të vazhdojë me analizën e mëtutjeshme të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata duhet të sqarojë një rrethanë juridike, që është e natyrës procedurale dhe ka të bëjë me afatin e parashtrimit të kësaj kërkesë. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson si në vijim: vendimi i fundit i gjykatës së rregullt pas së cilit përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka mundur të parashtrojë kërkesë në Gjykatë është katër muaj nga data e dorëzimit të Aktgjykimit [NJN. nr. 127/2016] të Gjykatës Themelore, ku në pjesën e udhëzimit për mjetin juridik thuhej se "*kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa*". Kjo në kuptimin formal juridik do të thotë që Gjykata mund ta refuzojë atë edhe në bazë të nenit 49 të Ligjit.
47. Megjithatë, duke marrë parasysh esencën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, dhe specifikën e rastit ku ai paraqet paqartësi lidhur me çështjen procedurale të pranimit të ankesës së tij nga ana e Gjykatës e Apelit, gjegjësisht "*pse Gjykata e Apelit herën e parë e pranoi ankesën e tij ndërsa herën e dytë po ajo gjykatë ankesën e tij e refuzoi si të palejuar*", Gjykata konsideron se ka nevojë që atë qëndrim juridik dhe trajtim të ndryshëm ta shpjegojë në vazhdim të aktvendimit për përfaqësuesin e parashtruesit, duke marrë parasysh edhe interesin personal të parashtruesit të kërkesës.

***Sqarimi i Gjykatës lidhur me çështjen e trajtimit të ndryshëm nga Gjykata e Apelit gjatë procedurës së shqyrtimit lidhur me zvogëlimin e dënimit, të zhvilluar në Gjykatën Themelore***

48. Kërkesa e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës është refuzuar nga Gjykata Themelore me aktvendimin [NJN. nr. 127/16] si e palejuar, me arsyetimin se *“konform nenit 65 par. 3 të Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale, është paraparë që procedura e konvertimit duhet të përfundoj para transferimit të personit të dënuar”*. Duke pasur parasysh rezultatin e procedurës në Gjykatën Themelore, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit.
49. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit tani ka aprovuar ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës dhe ka anuluar vendimin e Gjykatës Themelore, duke dhënë udhëzime se si duhet të veprojë në procedurën e përsëritur dhe në këtë mënyrë të eliminojë mangësitë dhe lëshimet e përcaktuara me Marrëveshjen dypalëshe në rastet kur kërkesa për konvertim të dënimit paraqitet pas njohjes së vendimit të gjykatës së huaj, pra pas përfundimit të transferimit të personit të dënuar. Gjykata vëren se Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur nuk nxori aktvendim, si në procedurën e shcallës së parë, por aktgjykim me të cilin e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për dy vepra penale të cilat, në kohën e kryerjes së veprës penale nga parashtruesi i kërkesës në Republikën e Shqipërisë, janë paraparë si vepra penale në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, duke shqiptuar njëkohësisht dënimin unik me burgim prej 12 vitesh.
50. Gjykata konstaton se aktgjykimi [NJN. nr. 127/16] i Gjykatës Themelore në procedurën e përsëritur përmban edhe dispozitën që thotë: *“Në bazë të nenit 63 paragrafi 2 të Ligjit për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale, kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa”*.
51. Duke pasur parasysh këtë rezultat të procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë të re në Gjykatën e Apelit, të cilën ajo e refuzoi duke konsideruar se ankesa ishte e paligjshme.
52. Gjykata dëshiron të theksojë se ka bërë një përmbledhje të shkurtër të thelbit të procedurës gjyqësore të parashtruesit të kërkesës si dhe rezultatit të saj në aspektin procedural, e cila është zhvilluar pranë gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës në lidhje me kërkesën për zvogëlim të dënimit me burg, të gjitha për të shqyrtuar sa më qartë thelbin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. Gjykata konsideron se kjo qasje i mundësoi asaj të përcaktojë se cilat janë argumentet kryesore të parashtruesit të kërkesës mbi bazën e të cilave ajo konsideron se janë shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 6, 13 të KEDNJ-së.
53. Rrjedhimisht, Gjykata konstatoi se pretendimi kryesor mbi të cilin parashtruesi i kërkesës e ndërton shkeljen e neneve të përmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ-së është se Gjykata e Apelit mbajti qëndrime të ndryshme në dy procedura lidhur me ankesat e tij të parashtruara ndaj vendimeve të Gjykatës Themelore. Më konkretisht, e para ishte Gjykata e Apelit në lidhje me ankesën e tij kundër aktvendimit [NJN. nr. 127/16] të Gjykatës Themelore, e aprovoi ankesën si të bazuar, ndërsa ankesën e tij të dytë lidhur me aktgjykimin [NJN. nr. 127/16] e Gjykatës Themelore në procedurë të përsëritur e refuzoi si ligjërish të palejueshme. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës konsideron se një qasje e tillë e Gjykatës së Apelit *“i ka pamundësuar parashtruesit të kërkesës të përdorë mjete juridike kundër vendimeve gjyqësore me të cilat janë shkelur të drejtat ose interesat e tij, siç përcaktohet në Kushtetutë”*.
54. Megjithatë, Gjykata, pavarësisht pretendimeve të parashtruesit të kërkesës i cili konsideron se në procedurën gjyqësore i janë shkelur të drejtat e tij nga nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës si dhe nenit 13 të KEDNJ-së, që në terma konkretë do të thotë “e

*drejta për mjet juridik*”, si dhe e drejta për *“mbrojtje gjyqësore e të drejtave”*, në procedurën për uljen e dënimit me burg, konsideron se këto të drejta hyjnë në sferën e *“të drejtave të mbrojtura”* në kuptimin e së drejtës kushtetuese për gjykim të drejtë nga neni 31 i Kushtetutës si dhe neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së. Në këtë kontekst, Gjykata konstaton se çështja e efektivitetit të ankesës si mjet juridik efektiv gjendet brenda këtyre procedurave.

55. Rrjedhimisht, Gjykata do t'i shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 të Kushtetutës në lidhje me nenin 13 të KEDNJ-së, përmes garancive procedurale të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse këto nene i mundësojnë gjykatës që të shqyrtojë në kuptimin procedural, procedurën e zhvilluar nga parashtruesi i kërkesës në bazë të së cilës pretendon shkelje të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës.
56. Në kontekst të sa më sipër, Gjykata thekson se GJEDNJ-ja në praktikën e saj ka arritur në përfundimin se është më kompetente për të dhënë kualifikimin ligjor të fakteve të paraqitura në kërkesë dhe se ajo nuk kufizohet apo lidhet me kualifikimin ligjor të parashtruesit të kërkesës. Bazuar në parimin *“iura novit curia”*, që në terma konkret do të thotë se palët në procedurë nuk e kanë për obligim të kualifikojnë ligjërisht kërkesën e tyre duke iu referuar dispozitave ligjore materiale përkatëse, por kur e bëjnë këtë (që në praktikë ndodh shumë shpesh), Gjykata nuk obligohet nga një kualifikim i tillë ligjor. Detyrë e palëve është që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat e bazojnë kërkesën e tyre, ndërsa detyrë e gjykatës është të konstatojë nëse kërkesa e paraqitur është e bazuar në dritën e pretendimeve që sipas mendimit të gjykatës, mund të jenë juridikisht të rëndësishme për zgjidhjen e kontestit.
57. Në lidhje me këtë, GJEDNJ, me iniciativën e saj, shqyrtoi kërkesat në lidhje me nenet dhe paragrafët e KEDNJ-së, të cilave parashtruesit e kërkesës nuk iu referuan, madje edhe në lidhje me dispozitat që ajo i kishte shpallur të papranueshme, me konkluzion të njëkohshëm se kërkesa ishte e pranueshme sipas një dispozite tjetër. Kjo për shkak se GJEDNJ vlerëson se faktet e deklaruara në kërkesë janë vendimtare për kualifikimin ligjor të pretendimeve të paraqitura në kërkesë, dhe jo vetëm baza ligjore në të cilën është referuar parashtruesi i kërkesës (shih aktgjykimin e GJEDNJ, [\*Serife Yiğit kundër Turqisë\*](#), kërkesa [nr. 3976/05](#), e 2 nëntorit 2010, pikat. 51–52 me referenca të mëtejme).
58. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh përmbajtjen e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të shqyrtojë pretendimet për shkeljen e së drejtës nga neni 32 i Kushtetutës dhe neni 13 i KEDNJ-së në lidhje me të drejtën nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së, por në të njëjtën kohë duke e kufizuar atë ekskluzivisht në procedurën që përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës ka iniciuar dhe adresuar para gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesën për zvogëlimin e dënimit me burg të parashtruesit të kërkesës.
59. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se neni 13 i KEDNJ-së i garanton çdo personi të drejtën për një mjet juridik efektiv brenda rendit juridik kombëtar kundër shkeljeve të të drejtave të njohura me KEDNJ. E drejta për mjet efektiv juridik është e drejtë plotësuese, por edhe e drejtë procedurale autonome. Natyra aksesore e kësaj të drejte do të thotë se shkelja saj mund të referohet vetëm si pjesë dhe në lidhje me shkeljen e një të drejte tjetër të njohur me KEDNJ. Nga ana tjetër, autonomia e saj do të thotë se zbatimi i kësaj dispozite nuk nënkupton domosdoshmërisht se më parë është bërë shkelje e ndonjë të drejte tjetër thelbësore nga KEDNJ. Në fakt, edhe në rastin kur Gjykata nuk ka vërtetuar se ka pasur shkelje të një të drejte thelbësore, ajo është e detyruar të verifikojë nëse ligji kombëtar përmban dispozita për mjetin efektiv juridik nga neni 13 i KEDNJ-së. Gjykata rikujton më tej se, sipas praktikës së GJEDNJ-së,

neni 13 i KEDNJ-së duhet të interpretohet në atë mënyrë që të garantojë një mjet efektiv përpara autoriteteve shtetërore” për këdo që pretendon se është viktimë e shkeljes së të drejtave dhe lirive të numëruara në KEDNJ (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së, *Klass kundër Gjermanisë*, kërkesa nr. 5029/71, Aktgjykimi i 6 shtatorit 1978, Seria A, nr. 28, f. 29, para. 64; dhe *Boyle dhe Rice kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 9659/82 dhe 9658/82 Vendimi i 27 marsit 1988, seria A, numër 131, paragrafi 52).

60. Në pajtim me praktikën e GJEDNJ-së, e drejta për mjet efektiv nënkupton ekzistencën e një mjeti juridik në çdo formë në rendin e brendshëm juridik, përmes të cilit mund të mbrohen efektivisht të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ. Mjeti juridik është efektiv nëse, në rendin e brendshëm juridik, sigurohet e drejta e anulimit të një akti që cenon një të drejtë ose nëse me këtë mjet akti mund të shqyrtohet në merita. Gjithashtu, efektiviteti i mjetit juridik përfshin edhe mundësinë për të korrigjuar shkeljen e të drejtave, si dhe që viktima e shkeljes të marrë një satisfaksion për dëmin e pësuar. Nëse mjeti juridik nuk i plotëson kushtet e cekura, ai nuk do të konsiderohet efektiv në kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së. Efektiviteti përfshin gjithashtu shqyrtimin e shkeljes në merita, si dhe marrjen e një vendimi për meritat e saj (shih aktgjykimet e GJEDNJ-së, *Rotaru kundër Rumanisë*, aktgjykim i 4 majit 2000, paragrafi 67; dhe *Asenov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, i 28 tetorit 1998, paragrafi 117).
61. Duke iu rikthyer rastit konkret të parashtruesit të kërkesës, Gjykata, për t’iu përgjigjur pretendimit të parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuara me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenin 13 të KEDNJ-së, duhet së pari të shikojë thelbin e të dy vendimeve të Gjykatës së Apelit si dhe thelbin dhe fushëveprimin e tyre në lidhje me procedurat që janë zhvilluar në Gjykatën Themelore përkitazi me kërkesën për ulje të dënimit, si dhe për të përcaktuar nëse një vendim i ndryshëm i Gjykatës së Apelit ka sjellë shkeljen e të drejtave të cilave parashtruesi i kërkesës u referohet në kërkesë.
62. Në lidhje me këtë, Gjykata, pasi shqyrtoi vendimin e parë, përkatësisht aktvendimin [P. nr. 937/20] të Gjykatës së Apelit konstaton se ka aprovuar ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës të paraqitur ndaj aktvendimit [NJN. nr. 127/16] të Gjykatës Themelore, si të bazuar, duke e bërë ankesën e paraqitur mjet juridik efektiv në lidhje me aktvendimin e Gjykatës Themelore. Megjithatë, Gjykata vëren se efektiviteti i saj si mjet juridik është vetëm në lidhje me gabimet procedurale të bëra nga Gjykata Themelore gjatë trajtimit të kërkesës për ulje të dënimit me burgim, ku nuk ka marrë parasysh specifikën e kërkesës së paraqitur. Gjykata vëren se kjo specifikë lidhet me kohën e paraqitjes së kërkesës, e cila këtu paraqet një karakteristikë të rëndësishme që ka ndikim procedural në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur për uljen e dënimit.
63. Më konkretisht, në rastet kur kërkesa për uljen e dënimit paraqitet pas transferimit të personit të dënuar, siç kishte ngjarë në këtë rast, atëherë gjykata kompetente, në këtë rast Gjykata Themelore, duhet i) ta shqyrtojë tërë procedurën penale të zhvilluar në gjykatën kompetente në shtetin ku personi është dënuar, ii) të shqyrtojë përkufizimin e veprës penale në lidhje me veprën penale të parashikuar me ligjin e brendshëm penal, iii) të përcaktojë lartësinë e dënimit të paraparë në lidhje me dënimin që parashihet me kodin penal të brendshëm për veprën penale të paraparë, iv) të vendosë në lidhje me përgjegjësinë e tij penale dhe, vi) të përcaktojë lartësinë e dënimit të tij”.
64. Prandaj, Gjykata e Apelit e aprovoi ankesën e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës vetëm për qëllim të korrigjimit të mangësive procedurale të bëra nga Gjykata Themelore, e cila, siç mund të shihet, nuk i ka plotësuar kriteret e parapara të cekura më lartë. Rrjedhimisht, vendimi i Gjykatës Themelore si i tillë, sipas konkluzionit të

Gjykatës së Apelit, nuk ishte në pajtim me të gjitha kriteret e Ligjit nr. 04/L-213 për bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale, Marrëveshjes dypalëshe, si dhe Konventës evropiane për transferimin e personave të dënuar.

65. Me vetë aktin e pranimit të ankesës së parashtruesit të kërkesës si mjet efektiv juridik, Gjykata e Apelit krijoi rrethana juridike në të cilat Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur duhej të vepronte në mënyrën e përcaktuar nga Gjykata e Apelit, duke zbatuar jo vetëm dispozitat ligjore por edhe standardet dhe kërkesat e Konventës evropiane për transferimin e personave të dënuar, në bazë të së cilës dy shtetet, Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë, kanë lidhur edhe marrëveshjen dypalëshe për ekstradim.
66. Më tej, Gjykata, duke shqyrtuar vendimin e dytë, përkatësisht aktvendimin [PN. nr. 430/2022], të Gjykatës së Apelit, të paraqitur si rezultat i aktgjykimit [NJN. nr. 127/16], të Gjykatës Themelore në procedurën e përsëritur kundër të cilit përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës parashtrroi ankesë, konstaton se ankesa është refuzuar nga Gjykata e Apelit, duke konstatuar se Gjykata Themelore ka marrë aktgjykim në të cilin ka vendosur në merita në lidhje me kërkesën për uljen e dënimit me burg, dhe se *“Vendimet nuk mund të ankimohen”*.
67. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit arriti në një përfundim të tillë duke shqyrtuar aktgjykimin e Gjykatës Themelore të cilin e kishte nxjerrë në procedurë të përsëritur. Me këtë rast konstatoi se shkeljet procedurale nuk vërehen më, pasi që Gjykata Themelore ka marrë vendim në merita lidhur me kërkesën për ulje të dënimit, ashtu siç ishte paraparë në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse, neni 63.2, i Ligjit nr. 04/L-213, ku thuhet *“Gjykata Themelore e Prishtinës është gjykata kompetente për të vendosur lidhur me procedurën e përmendur sipas paragrafit 1. të këtij neni. Vendimet nuk mund të ankimohen”*.
68. Gjykata konstaton se Gjykata e Apelit me të drejtë konkludoi se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj [NJN. nr. 127/2016], ka korrigjuar të gjitha mangësitë që i kanë shërbyer si bazë për anulimin e vendimit, për arsye se, i) në procedurën e përsëritur, Gjykata Themelore, para nxjerrjes së vendimit meritor, ka shqyrtuar në detaje procedurën penale që është zhvilluar në organeve kompetente gjyqësore në Republikën e Shqipërisë kundër parashtruesit të kërkesës, ii) ka përcaktuar se edhe me Kodin e Përkohshëm Penal të Republikës së Kosovës parashihet e njëjta veprë penale si vepra penale për të cilën parashtruesi i kërkesës është dënuar në Republikën e Shqipërisë, iii) e shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për veprën penale të kryer, iv) i shqiptoi atij dënimin me burg.
69. Konkretisht kjo do të thotë se kur Gjykata Themelore vendos në merita sipas procedurës për uljen e dënimit me burgim dhe vetë vendimi nuk ka mangësi procedurale, procedura përfundon aty. Në këtë mënyrë, palët e interesuara nuk kanë mjete juridike të parashikuara në ligj në formën e parashtrimit të ankesës në një gjykatë më të lartë, të cilën mund ta përdorin për të kontestuar vendimin e marrë.
70. Gjykata nuk e konsideron të pabazuar këtë konkluzion të Gjykatës së Apelit lidhur me refuzimin e ankesës së përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës për arsye se është pikërisht në pajtim me dispozitën ligjore të nenit 63.2 të Ligjit Nr. 04/L-213. Për më tepër, Gjykata posaçërisht dëshiron të theksojë se kjo qasje e Gjykatës së Apelit sigurisht që nuk bie ndesh me nenin 102 të Kushtetutës, sepse përmbajtja e nenit 102 të Kushtetutës është mjaft e qartë dhe parashikon se *“5. Garantohet e drejta për ankesë ndaj një vendimi gjyqësor, përveç nëse me ligj është përcaktuar ndryshe. E drejta e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme juridike, rregullohet me ligj. [...]”*.



71. Prandaj, Gjykata, duke pasur parasysh se i ka shqyrtuar në detaje të dyja procedurat në Gjykatën e Apelit në kontekstin e një shkeljeje të mundshme të neneve 32, 54 si dhe nenit 13 të KEDNJ-së, në kontekstin e të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, ka ardhur në një përgjigje, ku ajo konkludon se është e qartë se Gjykata e Apelit ka marrë dy vendime të ndryshme lidhur me dy ankesat e përfaqësuesit të parashtruesit të kërkesës, por është gjithashtu e qartë se ato vendime janë marrë në situata të ndryshme juridike që kërkonin qasje të ndryshme të saj, dhe se pikërisht qasja e ndryshme e Gjykatës së Apelit ishte plotësisht në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse të cilave ajo iu referua kur aprovoi për herë të parë ankesën. kundër vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore, si dhe kur e refuzoi ankesën kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në procedurë të përsëritur. Me këtë qëndrim të saj, Gjykata e Apelit eliminoi shkeljet e mundshme të së drejtës për mjet juridik të parashikuar në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, si pjesë e së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.
72. Prandaj, me kthimin dhe shqyrtimin e kërkesës për uljen e dënimit në merita nga ana e Gjykatës Themelore, janë përmbushur kërkesat e GJEDNJ-së, të cilat përcaktojnë se *“efektiviteti nënkupton ekzistencën e një mjeti juridik në çdo formë në rendin e brendshëm juridik që mund të mbrojë në mënyrë efektive të drejtat dhe liritë e garantuara me KEDNJ”*.
73. Duke pasur parasysh të gjitha sa më sipër, Gjykata vlerëson se me vendimmarrjen e ndryshme të Gjykatës së Apelit nuk ka ardhur deri te shkelja e neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës si dhe nenit 13 të KEDNJ-së në lidhje me të drejtat nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6, paragrafi 1, i KEDNJ-së.
74. Prandaj, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar sepse pas analizës u konstatua se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë (iii) e pretendimeve *“të pambështetura apo të paarsyetuara”*, prandaj, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit, si dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 23 maj 2023, njëzëri,

### VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani